

Enti i Statistikës së Kosovës punon në bazë të Rregullores 2001/14. Ligji mbi statistikat zyrtare është draftuar dhe pritet të aprovohet nga parlamenti. Deri në implementimin e ligjit, Enti i Statistikës së Kosovës punon në bazë të kësaj rregullore.

RREGULLORJA NR. 2001/14

PËR THEMELIMIN E ENTIT STATISTIKOR TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) të datës 10 qershor 1999.

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 datë 25 korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Pushtetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Me qëllim të themelimit të Entit Statistikor të Kosovës,

Shpall sa vijon:

Neni 1

Enti Statistikor i Kosovës

1.1 Me këtë rregullore themelohet Enti Statistikor i Kosovës (në tekstin e mëtejme "Enti")

1.2 Enti është përgjegjës për udhëheqjen e gjithëmbarshme të çështjeve lidhur me mbledhjen e të dhënave statistikore, analizën, përpunimin, shpërndarjen dhe arkivimin e tyre.

1.3 Në kryerjen e detyrave të tij, Enti u përmbahet parimeve të neutralitetit, objektivitetit, pavarësisë dhe racionalitetit profesional gjatë kryerjes së veprimtarive të tij.

1.4 Sipas nevojës, Enti mund të përpilojë dhe të bëjë rekomandime të politikës së punës që, ndër të tjera, kanë të bëjnë me strategjinë dhe politikën e udhëheqjes dhe zhvillimit të shërbimeve statistikore, duke përfshirë organizimin dhe udhëheqjen e shërbimeve statistikore, kornizën rregullative të shërbimeve statistikore, nxitjen e mundësisë së përdorimit të përgjithshëm të shërbimeve statistikore në mbështetje të demokratizimit dhe të zhvillimit ekonomik si dhe administrimin efikas të burimeve në dispozicion, duke përfshirë edhe kryerjen e regjistrimeve të përgjithshme dhe sondazheve statistikore.

1.5 Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Neni 2

Detyrat

Enti kryen detyrat e mëposhtme:

- (a) Zhvillon dhe sendërton strategjinë, politikën e punës dhe standardet e gjithëmbarshme për mbledhjen e të dhënave statistikore, mbarëshkrimin e informacioneve statistikore, përpunimin elektronik të të dhënave si dhe shpërndarjen e informacioneve dhe të dhënave statistikore;
- (b) Kujdeset që të gjitha të dhënat të sigurohen dhe të kumtohen duke u mbështetur në metodat dhe teknikat e njohura dhe përkatëse të përdorura në lëmin e statistikës;
- (c) Fut në përdorim dhe zhvillon shërbime të përparuara statistikore;
- (ç) Propozon, sipas nevojës, rregullore për çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet statistikore;

- (d) Kryen të gjitha detyrat e një Organi Rregullativ në lëmin e shërbimeve statistikore;
- (dh) Ofron të dhëna statistikore zyrtare lidhur me gjendjen ekonomike, demografike, sociale dhe të mjedisit në Kosovë;
- (e) Kryen regjistrime të popullsisë dhe sondazhe statistikore;
- (ë) Përpilon dhe mban regjistra të cilët do të përdoren për qëllime statistikore;
- (f) Mundëson shfrytëzimin e informatave dhe të dhënave statistikore për të gjithë shfrytëzuesit, siç janë organet dhe organizatat e administratës publike, të ekonomisë, institucioneve përkatëse shkencore dhe profesionale, medie dhe popullatës së gjerë, konform ligjit në fuqi;
- (g) Garanton kushte për interpretim standard të dhënave të mbledhura dhe të përpunuara dhe ndërmerr masa për t'iu kundërvënë shfrytëzimit të paligjshëm, qoftë të rastësishëm apo të qëllimshëm, të të dhënave statistikore;
- (gj) Koordinon dhe bashkërendon punët me organet dhe organizatat përkatëse sa i përket shërbimeve statistikore dhe
- (h) Koordinon veprimtaritë e agjencive dhe organizatave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare me qëllim të avancimit të një zhvillimi koherent dhe zbatimintë shërbimeve statistikore.

Neni 3

Fshehtësia dhe mbrojtja e të dhënave

3.1 Enti kujdeset që të dhënat individuale të mbledhura për qëllime statistikore, qoftë nga personat fizikë ose juridikë apo nga organet dhe organizatat e administratës publike (në tekstin e mëtejme "respondentët"), të trajtohen në mënyrën tejet sekrete dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Enti vendos një sistem efektiv të sigurisë me qëllim që të shmang edhe rrezikun më të vogël të shkeljes së fshehtësisë. Mbrojtja e të dhënave përshinë veçmas garancinë se të dhënat statistikore në formën e tyre të përgjithshme nuk do të shpërndahen në mënyrën e cila pa dashje do të mundësonte zbulimin e informative për respondentët individualë.

3.2 Të gjithë punonjësit e Entit nënshkruajnë një zotim për të mos shkelur dispozitat e fshehtësie të parashtruara në këtë rregullore dhe me ligjin në fuqi. Ky zotim i detyron punonjësit e Entit që të mos shkelin dispozitat e fshehtësisë të parashtruara në këtë rregullore dhe me ligjin në fuqi edhe pas përfundimit të detyrës së tyre në këtë Ent. Zbulimi e çfarëdo informate ose të dhëna sekrete nga cilido punonjës është thyerje materiale e kontratës së punës dhe mund të rezultojë në marrjen e masës disiplinore ndaj atij punonjësi.

3.3 Kontratat ose marrëveshjet me personat fizikë ose juridikë të cilët mbledhin, mbarështojnë, përpunojnë ose shpërndajnë të dhëna në emër të Entit përmban një dispozitë e cila kërkon nga ata që të mos shkelin dispozitat e fshehtësisë të parashtruara në këtë rregullore dhe me ligjin në fuqi dhe njëkohësisht parasheh se shkelja e këtij sekreti paraqet shkelje materiale të kontratës së marrëveshjes.

3.4 Kushtet për mbledhjen, mbarështimin, përpunimin, shfrytëzimin dhe lidhjen e të dhënave personale përkufizohen rregullohen konform ligjit në fuqi.

Neni 4

Obligimet e respondentëve

4.1 Të gjithë respondentët janë të obliguar, konform ligjit në fuqi, që të bashkëpunojnë me Entin dhe t'i ofrojnë atij të dhëna statistikore në kohë të duhur dhe me saktësi si dhe të bashkëpunojnë me Entit për t'a vërtetuar saktësinë e të dhënave të mbledhura. 4.2 Mospërbushja e detyrimeve sipas nenit 4.1 përbën kundërvajtje të dënueshme me gjobë sipas nenit 7 të më poshtëm.

Neni 5

Bashkëdrejtuesit e Entit

5.1 Enti udhëhiqet bashkërisht nga një bashkëdrejtues ndërkombëtar dhe njëbashkëdrejtues vendës (në tekstin e mëtejme "bashkëdrejtuesit") me përvojë të gjerë në lëmin e statistikës.

5.2 Bashkëdrejtuesit emërohen nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Bashkëdrejtuesit janë bashkërisht përgjegjës për:

- (a) Administrimin e Entit dhe garantimin e kryerjes së detyrave që i besohen atij;
- (b) Kompletimin me personel, organizimin dhe administrimin e Entit dhe nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe udhëzimeve të punës lidhur me çdo çështje që ka të bëjë me detyrat e Entit dhe
- (c) Udhëheqjen efikase dhe efektive të mjeteve që i ofrohen Entit nga Buxhetii Konsoliduar i Kosovës ose nga çfarëdo burimesh të tjera.

Neni 6

Praktikat dhe politikat e udhëheqjes dhe të punësimit

Bashkëdrejtuesit:

- (a) Zbatojnë politikë jodiskriminuese të personelit të cilat kanë për qëllim të sigurojnë që përbërja e punonjësve të Entit të pasqyrojë karakterin shumetnik të Kosovës; (b) Përpiqen që të sigurojnë një baraspeshë të drejtë gjinore në të gjitha fushat dhe nivelet në kuadër të Entit dhe
- (c) Kujdesen që i tërë punësimi të mbështetet në përgatitje profesionale, aftësidhe meritë.

Neni 7

Dënimet

7.1 Respondenti konsiderohet se ka bërë kundërvajtje me dashje apo pa dashje, nëkundërshtim me nenin 4.1 më lartë, nëse nuk ofron fare të dhëna statistikore, ose ofron të dhëna të rrejshme, jo të plota ose nuk ia ofron Entit në kohën e duhur.

7.2 Çdo respondent që bën kundërvajtje konform nenit 7.1 më lartë, pas shpalljesfajtor, i nënshtrohet dënimit me gjobë e cila nuk e tejkalon shumën prej një mijë markagjermane (1000 DM) dhe paguan shpenzimet përkatëse.

7.3 Shkelja e dispozitave të fshehtësisë konform kësaj rregulloreje përbën kundërvajtje dhe i nënshtrohet ndjekjes penale konform ligjit në fuqi.

Neni 8

Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresaadministrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 9

Ligji në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë në ligjin në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 2 korrik 2001.

(i nënshkruar)

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm